

“This Is My Gospel”—“This Is My Church”

By Elder Dale G. Renlund
Of the Quorum of the Twelve Apostles

“Ky Është Ungjilli Im” – “Kjo Është Kisha Ime”

Nga Plaku Dejjll G. Renland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

October 2024 general conference

This is the Savior’s gospel, and this is His Church (see 3 Nephi 27:21; Mosiah 26:22; 27:13). The combination of the two is powerful and transformative.

For centuries, black powder was the most powerful explosive available. It could launch cannon balls, but it wasn’t effective for most mining and road construction projects. It was just too weak to shatter rock.

In 1846 an Italian chemist named Ascanio Sobrero synthesized a new explosive, nitroglycerin. This oily fluid was at least a thousand times more powerful than black powder. It could easily shatter rock. Unfortunately, nitroglycerin was unstable. If you dropped it from a small height, it’d blow up. If it got too hot, it’d blow up. If it got too cold, it’d blow up. Even placed in a cool, dark room and left alone, it’d eventually blow up. Most countries banned its transportation, and many banned its manufacture.

In 1860 a Swedish scientist named Alfred Nobel began trying to stabilize nitroglycerin. After seven years of experimentation, he achieved his goal by absorbing nitroglycerin into a nearly worthless substance known as diatomaceous earth, or kieselguhr. Kieselguhr is a porous rock that can be crumbled into a fine powder. When mixed with nitroglycerin, kieselguhr absorbs the nitroglycerin, and the resultant paste can be shaped into “sticks.” In this form, nitroglycerin was much more stable. It could be safely stored, transported, and used with undiminished explosive power. Nobel named the combination of nitroglycerin and kieselguhr “dynamite.”

Ky është ungjilli i Shpëtimtarit dhe kjo është Kisha e Tij (shihni tek 3 Nepi 27:21; Mosia 26:22; 27:13). Ndërthurja e të dyjave është e fuqishme dhe shndërruese.

Për shekuj me radhë, baruti i zi qe lënda më e fuqishme plasëse në dispozicion. Ai mund të hidhte gjyle topash, por nuk qe i efektshëm për shumicën e projekteve të shpërthimit të shkëmbinjve dhe ndërtimit të rrugëve. Ishte thjesht tepër i dobët për ta copëtuar shkëmbin.

Në vitin 1846, një kimist italian, me emrin Ascanio Sobrero, sintetizoi një lëndë të re plasëse, nitroglicerinë. Ky lëng vajor ishte të paktën një mijë herë më i fuqishëm se baruti. Mund ta copëtonte lehtësisht shkëmbin. Për fat të keq, nitroglicerina qe e paqëndrueshme. Po të binte nga një lartësi e vogël, plaste. Po të nxehej shumë, plaste. Po të ftohej shumë, plaste. Madje edhe nëse lihej pa prekur në një dhomë të freskët, të errët, përfundimisht plaste. Shumica e vendeve e ndaluan transportimin e saj dhe shumë e ndaluan edhe prodhimin.

Në vitin 1860, një shkencëtar suedez, me emrin Alfred Nobel, filloi të përpiqej ta bënte të qëndrueshme nitroglicerinë. Pas shtatë vjetësh eksperimentim, e arriti synimin duke e përthithur nitroglicerinë në një substancë thuajse të padobishme të njohur si gur algash diatomeje ose fosilgur. Fosilguri është një gur poroz, i cili mund të shkërmoqet duke u bërë pluhur i imët. Kur përzihet me nitroglicerinë, fosilguri e përthith nitroglicerinë dhe brumit të formuar mund t’i jepet forma e “shkopinjve”. Në këtë formë, nitroglicerina qe shumë më e qëndrueshme. Ajo mund të ruhej, të transportohej dhe të përdorej në mënyrë të sigurt duke mos iu

Dynamite changed the world. It also made Nobel wealthy. Without a stabilizer, nitroglycerin was just too hazardous to be commercially valuable, as Ascanio Sobrero found out. By itself, as I mentioned, kieselguhr was of little value. But the combination of the two components made dynamite transformative and precious.

In a similar way, the combination of the gospel of Jesus Christ and The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints provides powerful and transformative benefits for us. The gospel is perfect, but a divinely commissioned church is required to preach it, maintain its purity, and administer its sacred ordinances with the Savior's power and authority.

Consider the combination of the Savior's gospel and His Church as established by the Book of Mormon prophet Alma. The Church was responsible for preaching "nothing save it were repentance and faith on the Lord, who [would redeem] his people." Using God's authority, the Church was responsible for administering the ordinance of baptism "in the name of the Lord, as a witness [of entering] into a covenant with him [to] serve him and keep his commandments." The people who were baptized took on themselves the name of Jesus Christ, joined His Church, and were promised great power through an outpouring of the Spirit.

People flocked to the Waters of Mormon to hear Alma preach the gospel. Though they revered those waters and the surrounding forests, the Lord's Church was not a location or a building, nor is it today. The Church is simply ordinary people, disciples of Jesus Christ, gathered and organized into a divinely appointed structure that helps the Lord accomplish His purposes. The Church is the instrument through which we learn the central role of Jesus Christ in Heavenly Father's plan. The Church offers the authoritative way for individuals to participate in ordinances and make lasting covenants with God. Keeping those covenants draws us closer to God, gives us access to His power, and transforms us into who He intends us to become.

Just as dynamite without nitroglycerin is unremarkable, the Savior's Church is special only if it is built on His gospel. Without the Savior's

dobësuar fuqia plasëse. Nobeli e quajti "dinamit" ndërthurjen e nitroglicerinës me fosilgurin.

Dinamiti e ndryshoi botën. Gjithashtu e bëri Nobelin të kamur. Pa lëndën që e bënte të qëndrueshme, nitroglicerina ishte tepër e rrezikshme për të qenë me vlerë për tregti, siç zbuloi Askanio Sobrero. Më vete, siç e përmenda, fosilguri, nuk kishte ndonjë vlerë të madhe. Por ndërthurja e dy përbërësve e bëri dinamitin diçka shndërruese dhe të çmuar.

Në mënyrë të ngjashme, ndërthurja e ungjillit të Jezut Krishtit me Kishën e Jezut Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme na sjell dobi të fuqishme dhe shndërruese. Ungjilli është i përkryer, por duhet një kishë me mandat hyjnor që ai të predikohet, ta ruajë pastërtinë dhe të administrojë ordinancat e tij të shenjta me fuqinë dhe autoritetin e Shpëtimtarit.

Merreni parasysh ndërthurjen e ungjillit të Shpëtimtarit me Kishën e Tij sikurse u themelua nga profeti i Librit të Mormonit, Alma. Kisha kishte përgjegjësinë për të predikuar "asgjë tjetër përveç pendimit dhe besimit në Zotin që [do ta] shëlb[onte] popullin e tij". Duke përdorur autoritetin e Perëndisë, Kisha që përgjegjëse për administrimin e ordinancës së pagëzimit "në emrin e Zotit, si një dëshmi [për] hyr[jen] në një besëlidhje me të [që] do t'i shërbeni[n] atij dhe do të zbatoni[n] urdhërimet e tij". Njerëzit që u pagëzuan, morën mbi veten emrin e Jezut Krishtit, iu bashkuan Kishës së Tij dhe atyre iu premtua fuqi e madhe nëpërmjet derdhjes së Shpirtit.

Njerëzit u mbledhën pranë Ujërave të Mormonit për të dëgjuar Almën tek predikonte ungjillin. Ndonëse kishin nderim për ato ujëra dhe pyjet që i rrethonin, Kisha e Zotit nuk ishte një vendndodhje ose një ndërtesë, as sot nuk është. Kisha është thjesht një grup njerëzish të zakonshëm, dishepuj të Jezut Krishtit, të mbledhur e të organizuar në një strukturë të caktuar hyjnisht, që e ndihmon Zotin të përmbushë qëllimet e Tij. Kisha është mjete nëpërmjet të cilit mësojmë rolin qendror të Jezut Krishtit në planin e Atit Qiellor. Kisha ofron mënyrën e autorizuar që individët të marrin pjesë në ordinancat dhe të bëjnë besëlidhje të përhershme me Perëndinë. Mbajtja e atyre besëlidhjeve na afron më shumë me Perëndinë, na jep qasje të fuqia e Tij dhe na shndërron në atë që Ai synon që të bëhemi.

Ashtu sikurse dinamiti pa nitroglicerinën nuk përbën asgjë të jashtëzakonshme, Kisha e Shpëtimtarit është e veçantë vetëm nëse ndërto-

gospel and the authority to administer the ordinances thereof, the Church isn't exceptional.

Without the stabilizing effect of kieselguhr, nitroglycerin had limited value as an explosive. As history has shown, without the Lord's Church, humanity's understanding of His gospel was likewise unstable—prone to doctrinal drift and subject to the influence of different religions, cultures, and philosophies. An amalgamation of those influences has been manifested in every dispensation leading up to this last one. Though the gospel was initially revealed in its purity, the interpretation and application of that gospel gradually took on a form of godliness that lacked power because the divinely authorized framework was absent.

The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints enables access to God's power because it is authorized by Him both to teach the doctrine of Christ and to offer the gospel's saving and exalting ordinances. The Savior yearns to forgive our sins, help us access His power, and transform us. He suffered for our sins and longs to pardon us from the punishment that we otherwise would deserve. He wants us to become holy and be perfected in Him.

Jesus Christ has the power to do this. He didn't simply sympathize with our imperfection and lament our eternal condemnation in consequence of sin. No, He went beyond that, infinitely beyond that, and restored His Church to enable access to His power.

The core of the gospel that the Church teaches is that Jesus Christ bore "our griefs, and carried our sorrows." He had "laid on him the iniquity of us all." He "endured the cross," broke "the bands of death," "ascended into heaven, and ... sat down on the right hand of God, to claim of the Father his rights of mercy." The Savior did all this because He loves His Father and He loves us. He has already paid the infinite price so He can "[claim] all those who have faith in him [and advocate]" for them—for us. Jesus Christ wants nothing more than for us to repent and come unto Him so that He can justify and sanctify us. In this desire, He is relentless and unwavering.

The access to God's covenantal power and

het mbi ungjillin e Tij. Pa ungjillin e Shpëtimtarit dhe autoritetin për të administruar ordinancat e tij, Kisha nuk ka ndonjë veçanti.

Pa ndikimin e qëndrueshmërisë së fosilguarit, nitroglicerina kishte vlerë të pakët si lëndë plasëse. Sikurse e ka treguar historia, pa Kishën e Zotit, kuptueshmëria e njerëzimit për ungjillin e Tij ka qenë po ashtu e paqëndrueshme: e prirur për largim nga doktrina dhe e nënshtruar ndaj ndikimit të feve, kulturave dhe filozofive të ndryshme. Një shkrirje e atyre ndikimeve është shpërfaqur në çdo periudhë ungjillore përpara kësaj të fundit. Megjithatë ungjilli fillimisht u zbulua i pastër, interpretimi dhe zbatimi i atij ungjilli gradualisht mori një formë perëndishmërie së cilës i mungonte fuqia sepse mungonte struktura e autorizuar në mënyrë hyjnore.

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme mundëson qasje në fuqinë e Perëndisë për shkak se autorizohet prej Tij për të dhënë mësim doktrinën e Krishtit si dhe për të ofruar ordinancat shpëtuese dhe ekzaltuese të ungjillit. Shpëtimtari është i etur të na i falë mëkatet, të na ndihmojë të kemi qasje në fuqinë e Tij dhe të na shndërrojë. Ai vuajti për mëkatet tona dhe është i dëshiruar të na shfajësojë nga dënimi që përndryshe do të meritonim. Ai dëshiron që të bëhemi të shenjtë dhe të përsosemi në Të.

Jezu Krishti ka fuqinë për ta bërë këtë. Ai nuk shfaqti thjesht mëshirë për papërsosuritë tonadhe [veç] vajtoi për ndëshkimin tonë të përjetshëm si pasojë e mëkatit. Jo, Ai shkoi përtej, pafundësisht përtej dhe e rivendosi Kishën e Tij për të mundësuar qasje në fuqinë e Tij.

Thelbi i ungjillit që Kisha jep mësim, është se Jezu Krishti i mbajti "sëmundjet tona dhe ... [mori] përsipër dhembjet tona". Ai bëri që të "bjerë mbi të paudhësia e ne të gjithëve". Ai "duroi kryqin", i këputi "lidhjet e vdekjes", "u ngjit në qiell dhe [u] ul në krahun e djathtë të Perëndisë, për t'i kërkuar Atit të drejtat e tij të mëshirës që ai ka mbi fëmijët e njerëzve". Shpëtimtari e bëri të gjithë këtë, sepse Ai e do Atin e Tij dhe Ai na do ne. Ai e ka paguar tashmë çmimin e pafund që të mund t'i "kërko[-]jë" të gjithë ata që kanë besim në të; dhe ... [t'i] përkrah[ë]"ata, të na përkrahë ne. Jezu Krishti nuk do asgjë më shumë sesa që ne të pendohejmë e të vijmë tek Ai në mënyrë që të mund të na shfajësojë e shenjtërojë. Në këtë dëshirë, Ai është i paepur dhe i palëkundur.

Qasja te fuqia besëlidhëse e Perëndisë dhe

His covenantal love is through His Church. The combination of the Savior's gospel and His Church transforms our lives. It transformed my maternal grandparents. My grandfather Oskar Andersson worked in a shipyard on Högmarsö, an island in the Stockholm archipelago. His wife, Albertina, and their children lived on the Swedish mainland. Once every two weeks, on Saturday, Oskar rowed his boat home for the weekend before returning to Högmarsö on Sunday evening. One day, while on Högmarsö, he heard two American missionaries preach the restored gospel of Jesus Christ. Oskar felt that what he heard was pure truth, and he was filled with unspeakable joy.

The next time he returned home, Oskar excitedly told Albertina all about the missionaries. He explained that he believed what they taught. He asked her to read the pamphlets they had given him, and he told her that he didn't think that any of their future children should be baptized as infants. Albertina was furious and threw the pamphlets on the rubbish heap. Not much was said between them before Oskar returned to work on Sunday evening.

As soon as he was gone, Albertina retrieved those pamphlets. She carefully compared their doctrine with the teachings in her well-worn Bible. She was astonished to feel that what she read was true. The next time Oskar returned home, he received a warm welcome, as did the copy of the Book of Mormon he brought with him. Albertina eagerly read, again comparing the doctrine to that in her Bible. Like Oskar, she recognized pure truth and was filled with unspeakable joy.

Oskar, Albertina, and their children moved to Högmarsö to be close to the few Church members there. A week after Oskar and Albertina were baptized in 1916, Oskar was called to be the group leader on Högmarsö. Like many converts, Oskar and Albertina faced criticism because of their new faith. Local farmers refused to sell them milk, so Oskar rowed across the fjord every day to purchase milk from a more tolerant farmer.

Yet during the ensuing years, Church membership on Högmarsö increased, in part because of Albertina's powerful testimony and burning

dashuria e Tij besëlidhëse, bëhet nëpërmjet Kishës së Tij. Ndërthurja e ungjillit të Shpëtimtarit me Kishën e Tij, na e shndërron jetën. Ajo i shndërroi gjyshërit e mi nga nëna. Gjyshi im, Oskar Andersoni, punonte në një kantier detar në Hëgmarshë, një ishull në arkipelagun e Stokholmit. Bashkëshortja e tij, Albertina, dhe fëmijët e tyre jetonin në pjesën joishullore të Suedisë. Çdo dy javë, të shtunave, Oskari voziste me varkë për të shkuar në shtëpi gjatë fundjavës, përpara se të kthehej në Hëgmarshë të dielën në mbrëmje. Një ditë, ndërsa ishte në Hëgmarshë, dëgjoi dy misionarë amerikanë të predikonin ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit. Oskari ndjeu se ajo që dëgjoi, ishte e vërteta e pastër dhe u mbush me gëzim të pashprehshëm.

Herën tjetër që u kthye në shtëpi, Oskari i tregoi me ngazëllim Albertinës gjithçka rreth misionarëve. I shpjegoi se i besonte asaj që dhanë mësim ata. I kërkoi që t'i lexonte broshurat që i kishin dhënë, dhe i tha se mendonte që asnjëri prej fëmijëve të tyre të ardhshëm nuk duhej të pagëzohej në foshnjëri. Albertina u inatos dhe i hodhi broshurat në pirgun e mbeturinave. Nuk i thanë më ndonjë gjë [kush e di çfarë] njëri-tjetrit derisa Oskari u kthye në punë të dielën në mbrëmje.

Sapo ai iku, Albertina i mori broshurat nga mbeturinat. E krahasoi me kujdes doktrinën e tyre me mësimet në Biblën e saj të vjetruar nga përdorimi. U habit kur ndjeu se ajo që lexoi, ishte e vërtetë. Herën tjetër që Oskari u kthye në shtëpi, ajo e priti shumë ngrohtë, sikurse bëri me kopjen e Librit të Mormonit që ai solli me vete. Albertina lexoi me padurim, sërish duke e krahasuar atë doktrinë me doktrinën në Bibël. Si Oskari, ajo e njohu të vërtetën e pastër dhe u mbush me gëzim të patreguar.

Oskari, Albertina dhe fëmijët e tyre u shpërngulën në Hëgmarshë që të ishin pranë anëtarëve të pakët të Kishës atje. Një javë pasi Oskari dhe Albertina u pagëzuan në vitin 1916, Oskar in e thirrën që të ishte udhëheqësi i grupit në Hëgmarshë. Si shumë të kthyer në besim, Oskari dhe Albertina u përballën me kritika për shkak të besimit të tyre të ri. Fermerët vendorë nuk pranonin t'u shitnin qumësht, ndaj Oskari voziste matanë fjordit çdo ditë për të blerë qumësht nga një fermer më tolerant.

Prapëseprapë, gjatë viteve pasuese, anëtarësia e Kishës në Hëgmarshë u shtua, pjesërisht për shkak të dëshmisë së fuqishme dhe zellit të zjar-

missionary zeal. When the group became a branch, Oskar was called as the branch president.

Members of that Högmarsö branch revered that island. This was their Waters of Mormon. This was where they came to a knowledge of their Redeemer.

Over the years, as they kept their baptismal covenant, Oskar and Albertina were transformed by the power of Jesus Christ. They longed to make more covenants and receive their temple blessings. To obtain those blessings, they permanently emigrated from their home in Sweden to Salt Lake City in 1949. Oskar had served as the leader of the members on Högmarsö for 33 years.

The combination of nitroglycerin and kieselguhr made dynamite valuable; the combination of the gospel of Jesus Christ and His Church is beyond price. Oskar and Albertina heard about the restored gospel because a prophet of God had called, assigned, and sent missionaries to Sweden. By divine commission, missionaries taught the doctrine of Christ and by priesthood authority baptized Oskar and Albertina. As members, Oskar and Albertina continued learning, developing, and serving others. They became Latter-day Saints because they kept the covenants they made.

The Savior refers to The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints as “my church” because He commissioned it to accomplish His purposes—preaching His gospel, offering His ordinances and covenants, and making it possible for His power to justify and sanctify us. Without His Church, there is no authority, no preaching of revealed truths in His name, no ordinances or covenants, no manifestation of the power of godliness, no transformation into who God wants us to become, and God’s plan for His children is set at naught. The Church in this dispensation is integral to His plan.

I invite you to commit yourself more fully to the Savior, His gospel, and His Church. As you do so, you will find that the combination of the Savior’s gospel and His Church brings power into your life. This power is far greater than dynamite. It’ll shatter the rocks in your way, transform you into an inheritor in God’s kingdom. And you will be “filled with that joy which is unspeakable and full of glory.” In the name of Jesus Christ, amen.

rtë misionar të Albertinës. Kur grupi u bë degë, Oskar in e thirrën si presidentin e degës.

Anëtarët e asaj dege në Hëgmarshë kishin nderim për atë ishull. Ky vend ishte si Ujërat e Mormonit për ta. Ai ishte vendi ku ata morën njohurinë për Shëlbuesin e tyre.

Përgjatë viteve, ndërsa e mbanin besëlidhjen e pagëzimit, Oskari dhe Albertina u shndërruan nga fuqia e Jezu Krishtit. Ata qenë të dëshiruar të bënin më shumë besëlidhje dhe të merrnin besëlidhjet e tempullit. Për t’i marrë ato bekime, ata emigruan përfundimisht nga shtëpia e tyre në Suedi drejt Solt-Lejk-Sitit në vitin 1949. Oskari pati shërbyer si udhëheqës i anëtarëve në Hëgmarshë për 33 vjet.

Ndërthurja e nitroglicerines me fosilgurin e bëri dinamitin me vlerë; ndërthurja e ungjillit të Jezu Krishtit me Kishën e Tij nuk ka çmim. Oskari dhe Albertina dëgjuan për ungjillin e rivedosur sepse një profet i Perëndisë kishte thirrur, caktuar dhe dërguar misionarë në Suedi. Me mandat hyjnor, misionarët e dhanë mësim doktrinën e Krishtit dhe me autoritetin e priftërisë e pagëzuan Oskar in dhe Albertinën. Si anëtarë, Oskari dhe Albertina vazhduan të mësonin, të zhvilloheshin dhe t’u shërbenin të tjerëve. Ata u bënë shenjtorë të ditëve të mëvonshme ngaqë i mbajtën besëlidhjet që bënë.

Shpëtimtari i referohet Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme me fjalët “kisha ime” sepse Ai i dha asaj mandatin për të përmbushur qëllimet e Tij: predikimin e ungjillit të Tij, ofrimin e ordinancave dhe besëlidhjeve të Tij dhe bërjen të mundur që fuqia e Tij të na shfajësojë e shenjtërojë. Pa Kishën e Tij, nuk ka autoritet, nuk ka predikim të të vërtetave të zbuluara në emrin e Tij, nuk ka ordinanca ose besëlidhje, nuk ka manifestim të fuqisë së perëndishmërisë, nuk ka shndërrim në atë që Perëndia do që të bëhemi dhe plani i Perëndisë kthehet në hiç. Kisha në këtë periudhë ungjillore është pjesë përbërëse e planit të Tij.

Ju ftoj t’u zotoheni më plotësisht Shpëtimtarit, ungjillit të Tij dhe Kishës së Tij. Ndërsa e bëni këtë, do të zbuloni se ndërthurja e ungjillit të Shpëtimtarit me Kishën e Tij sjell fuqi në jetën tuaj. Kjo fuqi është shumë më e madhe se ajo e dinamitit. Ajo do t’i thërrmojë shkëmbinjtë që ju zënë udhën, do t’ju shndërrojë në një trashëgimtar në mbretërinë e Perëndisë. Dhe ju do të “mbush[eni] me atë gëzim që është i patregueshëm dhe plot lavdi”. Në emrin e Jezu Krishtit,

amen.